

VENDIM
Nr. 190, datë 4.3.2020

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS
BASHKËPUNUESE TË GUAJANËS, PËR PËRJASHTIMIN NGA KËRKESAT PËR
VIZË PËR MBAJTËSIT E PASAPORTAVE DIPLOMATIKE, PASAPORTAVE TË
SHËRBIMIT DHE PASAPORTAVE TË ZAKONSHME**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Kryeministrit dhe ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Bashkëpunuese të Guajanës, për përjashtimin nga kërkesat për vizë për mbajtësit e pasaportave diplomatike, pasaportave të shërbimit dhe pasaportave të zakonshme, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

MARRËVESHJE

**MIDIS KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS BASHKËPUNUESE TË GUAJANËS, MBI PËRJASHTIMIN
NGA KËRKESAT PËR VIZË PËR MBAJTËSIT E PASAPORTAVE DIPLOMATIKE,
PASAPORTAVE TË SHËRBIMIT DHE PASAPORTAVE TË ZAKONSHME**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Bashkëpunuese të Guajanës (më poshtë referuar individualisht si “Palë Kontraktuese” dhe kolektivisht si “Palët Kontraktuese”);

me dëshirën për të forcuar marrëdhëniet dhe bashkëpunimin ekzistues miqësor, si dhe për të lehtësuar udhëtimin midis dy vendeve, duke e parë atë si një mjet të rëndësishëm për të forcuar lidhjet dhe për të mbështetur zhvillimin në të gjitha fushat me interes të ndërsjellë;

bien dakord si më poshtë:

Neni 1

Qytetarët e secilit prej vendeve, që janë zotërues të pasaportave të vlefshme diplomatike, të pasaportave të shërbimit ose të pasaportave të zakonshme, të lëshuara nga Palët Kontraktuese, përjashtohen nga kërkesat për viza hyrjeje, daljeje ose transiti, përmes territorit të Palës tjetër Kontraktuese për një periudhë jo më shumë se 90 (nëntëdhjetë) ditë brenda gjashtë muajsh brenda periudhës prej 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditësh.

Neni 2

Qytetarëve të secilit prej vendeve që kanë ndërmend të qëndrojnë më shumë se 90 (nëntëdhjetë) ditë rresht në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, siç përmendet në nenin 1 të kësaj Marrëveshjeje, u kërkohet të marrin vizën përkatëse para mbërritjes ose, nëse ndodhen në

territorin e Palës tjetër Kontraktuese, të aplikojnë për vizë para skadimit të 90 (nëntëdhjetë) ditëve rresht.

Qytetarët e secilës prej Palëve Kontraktuese, të cilët nuk janë në gjendje të dalin nga territori i Palës tjetër Kontraktuese, brenda periudhës së përcaktuar në paragrafin e parë të nenit 3, të kësaj Marrëveshjeje, për shkak të rrethanave të jashtëzakonshme (sëmundje ose fatkeqësi natyrore) dhe kanë dokumente ose prova të tjera të besueshme që vërtetojnë rrethana të tilla, mund të aplikojnë pranë autoriteteve përkatëse për lejen e zgjatjes së qëndrimit të tyre në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, për një periudhë të përshtatshme, të nevojshme për t'u kthyer në vendin e shtetësisë së tyre ose vendbanimin e tyre të përhershëm.

Neni 3

Qytetarët e secilit vend, në përputhje me nenin 1, mund të hyjnë në territorin e Palës tjetër Kontraktuese ose të dalin nga ai në çdo port ose kufi të hapur për trafik ndërkombëtar për udhëtarët, me kusht që ata të përmbushin kërkesat e ligjeve dhe rregulloreve të vendit tjetër në lidhje me këtë hyrje, lëvizje dhe qëndrim nga të huajt.

Neni 4

1. Qytetarët e secilës Palë Kontraktuese, që mbajnë pasaporta diplomatike, pasaporta shërbimi ose pasaporta të zakonshme, të cilët janë caktuar në misione diplomatike, konsullore ose përfaqësitë e organizatave ndërkombëtare në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, përjashtohen nga kërkesa për vizë për të hyrë, dalë ose për të kaluar transit në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, për periudhën e emërimit të tyre.

2. Dispozitat e paragrafit I të këtij neni zbatohen, gjithashtu, edhe për anëtarët e familjeve të tyre që kanë pasaporta të vlefshme diplomatike, pasaporta shërbimi dhe pasaporta të zakonshme.

Neni 5

Qytetarët e secilës Palë Kontraktuese, në rast të humbjes ose të dëmtimit të pasaportave të vlefshme diplomatike, pasaportave të shërbimit ose pasaportave të zakonshme gjatë qëndrimit në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, do të dalin nga territori i këtij shteti në bazë të dokumenteve të reja të udhëtimit, të lëshuara nga misioni diplomatik ose konsullor i vendit të shtetësisë së tyre.

Neni 6

Në frymën e ruajtjes së interesave publikë, luftimit të migracionit të paligjshëm dhe përgjigjes së shqetësimeve për sigurinë e të dyja vendeve; të dyja palët, në përputhje me ligjet dhe rregulloret e brendshme, marrin përsipër të bëjnë çmos për të ndaluar çdo person të padëshiruar dhe qytetarë të vendeve të treta të hyjnë në territorin e njëri-tjetrit.

Neni 7

1. Secila Palë Kontraktuese ka të drejtë të mohojë hyrjen në territorin e saj të qytetarëve të Palës tjetër Kontraktuese ose të anulojë ose të shkurtojë qëndrimin e tyre në vend, në rastin kur individ kryen veprime që shkelin ligjet dhe rregulloret e Palës pritëse.

2. Pala tjetër Kontraktuese do të kërkojë daljen pa vonesë dhe formalitete të mëtejshme, të çdo qytetari të Palës tjetër Kontraktuese që ka paraqitur dokumente false ose të falsifikuara pranë autoriteteve kufitare të Palës tjetër Kontraktuese, ose që ka tejkaluar periudhën e lejuar të

qëndrimit, ose që ka shkelur rregullat ekzistuese që rregullojnë procedurat e hyrjes dhe të daljes në Palën tjetër Kontraktuese.

Neni 8

1. Palët Kontraktuese do të shkëmbejnë, përmes kanaleve diplomatike, ekzemplarë të pasaportave të vlefshme diplomatike, pasaportave të shërbimit ose pasaportave të zakonshme, të listuara në shtojcën e kësaj Marrëveshjeje, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë pas datës së nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje.

2. Në rast të futjes së pasaportave të reja diplomatike, të shërbimit ose të zakonshme të listuara në shtojcën e kësaj Marrëveshjeje, ose në raste të ndonjë modifikimi në pasaportat e vlefshme, Palët njoftojnë njëra-tjetrën mbi këto ndryshime dhe shkëmbejnë, përmes kanaleve diplomatike, ekzemplarë të dokumenteve të tilla të udhëtimit jo më vonë sesa 30 (tridhjetë) ditë para hyrjes në fuqi të tyre.

Neni 9

Kjo Marrëveshje nuk ushtron ndikim mbi detyrimin e qytetarëve të secilës Palë Kontraktuese për të respektuar ligjet dhe rregulloret në fuqi në territorin e Palës tjetër Kontraktuese.

Neni 10

Kjo Marrëveshje nuk cenon të drejtën e autoriteteve kompetente të Palëve Kontraktuese t'i refuzojnë hyrjen ose qëndrimin një mbajtësi të një diplome diplomatike, pasaporte shërbimi ose pasaporte të zakonshme të Palës tjetër Kontraktuese, siç parashikohet në nenin 1, nëse një person i tillë konsiderohet si i padëshirueshëm ose *persona non grata*.

Neni 11

1. Secila Palë Kontraktuese mund të pezullojë përkohësisht ose plotësisht, ose pjesërisht, zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, për arsye të sigurisë kombëtare, rendit publik ose shëndetit publik. Kur njëra Palë Kontraktuese vendos të pezullojë Marrëveshjen, sipas përcaktimeve më sipër, ajo e njollon Palën tjetër Kontraktuese për pezullimin, përmes kanaleve diplomatike të Palës tjetër Kontraktuese, jo më vonë se 48 (dyzet e tetë) orë para një pezullimi të tillë.

2. Pala Kontraktuese që vendos të pezullojë zbatimin e kësaj Marrëveshjeje për arsyet e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, e informon në të njëjtën mënyrë Palën tjetër Kontraktuese për rinovimin e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 12

Çdo mosmarrëveshje që lind ndërmjet Palëve Kontraktuese nga interpretimi ose zbatimi i kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet përmes konsultimeve dhe negociatave.

Neni 13

Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet me pëlqimin me shkrim të ndërsjellë të Palëve Kontraktuese. Çdo ndryshim ose plotësim i kësaj Marrëveshjeje, të miratuar nga Palët, do të hyjë në fuqi në përputhje me paragrafin I të këtij neni.

Neni 14

1. Kjo Marrëveshje mbetet në fuqi për një periudhë të pacaktuar kohe dhe hyn në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim, përmes kanaleve diplomatike, përmes të cilave Palët Kontraktuese konfirmojnë përfundimin e procedurave të brendshme ligjore, të kërkuara për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshje.

2. Secila Palë Kontraktuese mund ta ndërpresë këtë Marrëveshje në çdo kohë me një njoftim me shkrim, përmes kanaleve diplomatike, dhe përfundimi do të hyjë në fuqi 90 (nëntëdhjetë) ditë pas marrjes së njoftimit nga pala tjetër.

Në prani të tyre, të nënshkruarit, me autorizimin e duhur nga qeveritë e tyre përkatëse, e nënshkruajnë këtë Marrëveshje.

Bërë në Uashington, më 27 janar 2020, në dy kopje origjinale, secila në shqip dhe në anglisht, me të dyja tekstet autentike. Në rast mospërputhjes në interpretimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, epërsi ka teksti në gjuhën angleze.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Floreta Faber

Ambasadore e Jashtëzakonshme dhe Fuqiplotë

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS
BASHKËPUNUESE TË GUAJANËS

Riyad Insanally

Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë